

KRIJIMI I MUNDËSIVE PËR PUNËSIM TË TË RINJVE NË RAJONET RURALE

HYRJE

Të rinjtë nëpër mjediset rurale janë ardhmëria e bujqësisë dhe industrive tjera rurale, por atyre shpesh ju mungojnë drejtimet dhe mbështetja që janë të domosdoshme që të mund tërësisht të kontribuojnë për zhvillimin e komuniteteve të tyre. Njohja e aspiratave të tyre për zhvillim personale, dhe zgjidhja e problemeve të tyre, janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin e barabartë dhe të qëndrueshëm në viset rurale.

Në nivel global, bujqësia duhet të realizojë rreth 60% rritje të prodhimtarisë, për të plotësuar kërkesën për ushqim deri më 2050, dhe në kohën e njëjtë duke zgjedhur sfidat e ndryshimeve klimatike dhe degradimet natyrore të resurseve ekzistuese (FAO, IFAD dhe ILO 2012). Duke marrë këtë parasysh, qartë është nevoja e investimit në gjeneratat e ardhshme të të rinjve në mjediset rurale.

Rajoni juglindor është një prej tetë rajoneve të planifikimit në Republikën e Maqedonisë, të themeluar në përputhje me Ligjin për Zhvillim të Barabartë Rajonal 2007 dhe paraqet një njësi themelore për planifikim të zhvillimit në Strategjinë për Zhvillim Rajonal. Rajoni përfshin sipërfaqe prej 2.835 km², gjegjësisht 10.9% të sipërfaqes së plotë të shtetit. E përbëjnë gjithsej 10 komuna: Komuna Bogdanci, komuna Bosilovë, komuna Vallandovë, komuna Vasilevë, komuna Gjevgjeli, komuna Dojran, komuna Konce, komuna Novo Sellë, komuna Radovish dhe komuna Strumicë, me numrin e plotë të banorëve prej 171.416 dhe dendësi të popullatës prej 63.2 banorë në km².

Karakteristike për Rajonin Juglindor është që në vitin 2012 është shënuar shkalla më e lartë e punësimit prej 60.9% në krahasim me rajonet tjera dhe shkalla më e ultë e papunësisë prej 13.8%. Neto rroga mesatare e paguar për të punësuar në Rajonin Juglindor në vitin 2012 ka qenë 16.600 denarë, gjegjësisht 79.4% të mesatares kombëtare. Rajoni Juglindor merr pjesë me 9.7% në formimin e PBB të plotë të Republikës së Maqedonisë (CRJI, 2018).

Një problem i madh në Rajonin Juglindor paraqet shpërngulja e personave të rinj. Mungesa e mundësisë të vazhdueshme për punë në mjediset rurale është një prej arsyeve për të cilat të rinjtë largohet në nivele të pa imagjinuara. Andaj, me ndryshimin e dinamikës së jetës në mjediset rurale, ashtu paraqitet edhe nevoja për krijimin e mundësive të reja që të rinjtë të kontribuojnë në zhvillimin e komuniteteve të tyre rurale, dhe me këtë, edhe gjithë rajonin si tërësi.

ZBULIME KRYESORE

Të rinjtë nga mjediset rurale jo shpesh janë të ftuar të marrin pjesë në marrjen e vendimeve në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar, ndërsa shkathtësitë e tyre shpesh janë të nënçmuar.

Të rinjtë kryesisht mendohen për vëzhgues pasim të proceseve të funksionimit të një shoqërie, në vend që të jenë agjentë aktiv të aftë për zgjedhjen e problemeve. Si të atillë, ata jo shpesh janë të përfshirë në procese të marrjes së vendimeve ose debate, dhe shpesh përballohen me huti negative për shkathtësitë dhe aftësitë e tyre. Nënvlërësimi i kapaciteteve të të rinjve gjithashtu manifestohet në barrierat që i kufizojnë të rinjtë të marrin pjesë në aktivitete afariste.

Mundësi të kufizuar e të rinjve nga mjediset rurale të realizojnë fitimin e denjë

Të rinjtë përballohen me pengesa në qasjen në shërbime aktive financiare. Këto kufizime duhet të tejkalohen, për të krijuar mundësi të denjë të jetës për të rinjtë në mjediset rurale. Mungesa e përvojës së të rinjve, naiviteti, organizimi i dobët dhe mungesa e zërit e pengojnë pjesëmarrjen e tyre në programet bashkëkohore zhvillimore për përmirësimin e mjediseve rurale. Më tutje, fermerët e rinj kanë nevojë për ndihmë në përfitimin e qasjes së qëndrueshme në resurse natyrore.

Arsimi rural vazhdon të ngec mbrapa

Kur personat e rinj nga mjediset rurale nuk kanë shkathtësi themelore siç janë aftësia për të analizuar informacione dhe të përshtaten dhe të përdorin teknologji të reja, atëherë nuk ka shumë gjasa që të vizitojnë trajnime të dobishme për zhvillim të mëtutjeshëm. Gjithashtu, një sfidë tjetër është edhe cilësia e dobët dhe rëndësia e kufizuar e arsimit rural.

Mungesa e mundësive në mjediset rurale shpesh i detyron të rinjtë të migrojnë

Shkalla e migracionit rrit shtypjen mbi tregjet urbane të punës dhe shërbimeve. Që të bëhet migracioni të jetë më tepër një zgjedhje personale dhe jo nevojë, duhen investime për të krijuar një punësim të denjë të të rinjve në mjediset rurale. Shumë të rinj kanë qëndrim negativ në lidhje me veprimtarinë rurale dhe bujqësore, ndërsa kjo shpesh është rezultat i rekomandimeve të mësuara negative nga sistemet aktuale për arsim rural, si dhe nga shqyrtimi personal i realitet ku rritja e ultë e prodhimtarisë së bujqësisë i kufizon mundësitë që i kanë në dispozicion të rinjtë në mjediset rurale. Qëndrimet e tyre, gjithashtu, janë nën ndikim të realitetit në jetës rurale, me opsione të kufizuara të infrastrukturës komunikimit dhe kulturore-argëtuese.

Në bazë të hulumtimit të zbatuar në vitin 2018 (AP, 2018), numri i personave të papunë në Rajonin Juglindor është 16.098 persona, prej cilëve 7.175 janë gra, ndërsa numri i personave aktiv që kërkojnë punë është 6.129, prej të cilëve 2.563 janë gra. Prej personave tjerë 9.969 që nuk janë kërkues aktiv të punës, pjesa më e madhe e tyre vetëm më kanë migruar ose kanë në plan të migrojnë. Hulumtimi tregon që në periudhën prej 2012 deri më 2018, më tepër se 7.000 persona kanë migruar nga Rajoni Juglindor. Të rinjtë përfaqësojnë më tepër se 60% të personave të papunë në Rajonin Juglindor, ndërsa më tepër se 90% të personave që migrojnë nga Rajoni Juglindor.

DREJTIME DHE REKOMANDIME

Dinamika e jetës në mjediset rurale ndryshon dhe janë të nevojshme qasje të reja për të përgjigjur sfidave dhe mundësive me të cilat përballohemi sot. Në shkallë më të madhe ose më të vogël, të gjitha këto do të ndikojnë mbi mundësinë e mbijetesës dhe për krijimin e një jete të denje me të cilat përballohen të rinjtë në mjediset rurale.

Rekomandimet që ofrojmë janë të gjera, por ndaj këtij problemi duhet të merret një qasje e gjerë dhe në gjitha nivelet, atë lokale, rajonale dhe kombëtare, me anë të politikave dhe praktikave përkatëse. Nga përvoja jonë e mëhershme dhe me anë të punës së tematikës konkrete dhe hulumtimeve e zbatuar për këtë temë, dhe nga analizimi i studimeve dhe hulumtimeve relevante nga koj temë në botë (IFAD, 2010, 2011; FAO 2012; ILO, 2012)” më poshtë janë dhënë drejtimet prioritare për krijimin e mundësive më të mira për të rinjtë. Këtu përfshijmë edhe nevojën që të mundësohet mbështetje konkrete për të rinjtë për shfrytëzimin e fondeve në dispozicion sipas masave në Programin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe programin IPARD2, si dhe mundësim i qasjes për përdorimin e burimeve tjera të mbështetjes së projekteve për interesimin e të rinjve, siç janë fondet sociale të BE-së dhe UNDP-së.

Këto drejtime dhe rekomandime përfshijnë:

1. Krijimi i dinamikës së re të jetës në mjediset rurale

Mundësi për ndryshime të mënyrës së zbatimit të biznesit

- 1.1.1. Investime më të mëdha publike dhe private në bujqësi dhe industrinë rurale
- 1.1.2. Mbështetje të inovacioneve të gjelbër bujqësore dhe burime të ripërtërirë të energjisë
- 1.1.3. Krijimi i rritjes së qëndrueshme në ekonominë rurale
- 1.1.4. Zgjerimi i shërbimeve për teknologjinë informative dhe komunikatave (TIK) dhe krijimi i rrjeteve më të fuqishme rurale dhe urbane

2. Përmirësim të pjesëmarrjes së të rinjve nga mjediset rurale në gjitha nivelet e shoqërisë

2.1. Ngritje e vetëdijes së palëve të interesuara lokale, rurale, rajonale dhe kombëtare për rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e marrjes së vendimeve

- 2.1.1. Mbështetje të rrjeteve rinore për përforcimin e kapaciteteve të tyre
- 2.1.2. Lehtësimi i formimit të rrjeteve të përfaqësuesve rural të të rinjve për shkëmbim të përvojave dhe informacioneve
- 2.1.3. Dhënia e mundësisë që zërat e rrjeteve rinore rurale të jenë pjesë e proceseve të marrjes së vendimeve

2.2. Pajisja e mjediseve rurale me infrastrukturën e nevojshme

2.2.1. Përmirësimi i infrastrukturës themelore dhe shërbimeve komunale, përfshirë edhe rrugët, entet banesore dhe shëndetësore, ujë, energji elektrike dhe TIK

2.2.2. Zhvillimi i lokacioneve publike për të rinjtë që të shoqërohen dhe në konsultim me të rinjtë, organizimi i aktiviteteve argëtuese dhe kulturore

3. Themelimi i masave për të rinjtë nga viset rurale që të fitojnë të ardhura edhe jashtë fermës

3.1. Ulja e kufizimeve të të rinjve në qasjen e tokave

3.1.1. Promovimi i trajnimeve dhe sigurimi i mbështetjes teknike për zgjerimin e aktiviteteve për fitim që kërkojnë pak ose aspak tokë që të paguhen në kuptimin financiar

3.1.2. Zbatimi i kurseve për ndërtimin e kapaciteteve të pronarëve të rinj të bizneseve të përshtatur sipas nevojave të tyre dhe nevojave të mjedisit rural

3.1.3. Punë aktive me grupet e të rinjve për të zhvilluar mekanizma inovative për qasje në tokë të punueshme

3.2. Lehtësimi i qasjes të rinjve nga mjedise rurale në financa

3.2.1. Zbatimi i kurseve për shkrim/lexim financiar dhe disiplinë financiare për të rinjtë e mjediseve rurale

3.2.2. Nisja e partneriteteve të institucioneve financiare dhe të rinjve nga mjediset rurale për promovimin dhe zhvillimin e produkteve financiare të përshtatura sipas nevojave të tyre

3.2.3. Mbështetja për krijimin e institucioneve financiare në pronësi lokale, me veprimtari kryesore për financim të mbështetjes së personave të rinj

3.3. Krijimi i mjedisit të volitshëm ekonomik për sipërmarrësit e rinj

3.3.1. Lehtësimi i përdorimit të ITK në bujqësi dhe shërbimet e ngjashme, si dhe në veprimtaritë tjera rurale

3.3.2. Vendosja e lidhjeve mes sipërmarrësve, dhënësve të shërbimeve afariste dhe grupeve rinore

3.3.3. Mbështetja e iniciativave që krijojnë të ardhura për të rinjtë në mjediset rurale dhe zhvillimi i mekanizmave për uljen e rreziqeve me të cilat përballohen sipërmarrësit e rinj

4. Sigurimi i arsimit relevant për të rinjtë e mjediseve rurale, lidhur me nevojat e tregut të punës

4.1. Ngrirja e shkathtësive të të rinjve, që janë të nevojshme në tregun e punës

4.1.1. Ulja e shpenzimeve të drejtpërdrejta dhe ato jo të drejta për shkollim

4.1.2. Përshtatja e arsimit dhe trajnimit sipas nevojave të vërteta të mjediseve rurale

4.1.3. Integrimi i arsimit formal dhe joformal për fitimin e kompetencave që janë me rëndësi thelbësore për transformimin e sektorëve bujqësor, rural dhe ato jo-bujqësor, siç janë sipërmarrja, fermat bashkëkohore dhe përdorimi i inovacioneve të reja të gjelbër

4.2. Ngritja e sistemeve formale dhe joformale për arsim dhe trajnim

4.2.1. Sigurimi i stimulimeve (bonuese, rroga më të larta, banesa të subvencionuar, telefona celular) për mësime dhe trajnuesit që do të punojnë në mjediset e largëta rurale

4.2.2. Përfshirja e banorëve lokale, mes të cilëve edhe të rinjtë, në planifikimin e arsimit, me anë të cilës do të ndërtohen partneritete mes shkollave dhe komuniteteve

4.2.3. Prezantimi i shkathtësive të reja në arsimin formal dhe joformal për ndërtimin e shkathtësive dhe krijimi i standardeve edukative, përfshirë edhe për vlerësimin dhe certifikimin

4.2.4. Dhënia e prioritetit për pjesëmarrjen e të rinjve në kurset për trajnim, duke ofruar stimulime ose ndërtime për dhënësit e shërbimeve për secilin person të ri të trajnuar

4.2.5. Ofrimi i kapitalit fillestar për hapjen e ndërmarrjeve të reja nga të rinjtë si pjesë e programeve arsimore joformale

KONKLuzion

Me anë të zbatimit të strategjike afatshkurtër dhe afatgjatë dhe masave që do të zgjedhin sfidat aktuale për punësimin e të rinjve në mjediset rurale, do të zvogëlojmë migracionin e tyre, dhe do të nxisim zhvillimin e tyre dhe ato do të vendosi themelin për zhvillimin e suksesshëm afatgjatë të qëndrueshëm të viseve rurale.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për Rajonin Juglindor të Planifikimit të Republikës së Maqedonisë, kryesisht për zvogëlimin e trendit për migrim të personave të rinj, zvogëlimi i papunësisë dhe përmirësimi i kushteve për punë, dhe gjithashtu për zhvillimin e plotë të rajonit, që pëson nga mungesa e fuqisë punëtore dhe me trend të dobët të zvogëlimit të natalitetit dhe vjetërsimit të popullatës.

Drejtimet dhe rekomandimet me lartë janë bazë solide për formulimin e politikave publike. Problemi me mbajtjen dhe punimin e drejtë të të rinjve në mjediset rurale meriton të jetë prioritet kryesor, veçanërisht në nivelin lokal. Drejtimet e propozuar duhet edhe më tutje në mënyrë të hollësishme të hartohen dhe sipas kompetencave të institucioneve dhe politikave, me plan dhe me kohë të intervenohet me programe dhe masa përkatëse. Në fakt, secila pikë dhe nënpikë në propozim drejtimet paraqet një temë për analizë më të thellë, gjegjësisht projekt.

BURIMET:

AP (2018) Rajoni Juglindor i Republikës së Maqedonisë Situata aktuale e tregut të punës. Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë

ESHS (2018) MAKSTAT baza e të dhënave, www.stat.gov.mk; Enti Shtetëror i Statistikës.

IFAD (2010) Investimi në Ardhmëri: Krijimi i Mundësive për Personat e Rinj Rural.

IFAD (2011) Raporti për Varfërinë Rurale 2011: Realitete të Reja, Sfida të Reja, Mundësi të Reja për Gjeneratat e Ardhshme.

IFAD (2013) Përmirësimi i standardit jetësor i të rinjve në mjediset jetësore - Rozmari Vargas - Lindius dhe Dejevid Sutie, me mbështetjen e Sektorit për Krijimin e Politikave.

IFAD, FAO dhe ILO (2012) Promovim i punës së mirë dhe produktive për të rinjtë në mjediset rurale: Pasqyra e Strategjive dhe programeve (Punëtori për përputhjen e strategjive dhe programeve aktuale të IFAD, FAO dhe ILO).

GLA BELLASICA – OGRAZH DEN (2016) Strategjia për Zhvillim Rural të Mjedisve Rurale

GLA BOJMIJA (2018) Strategjia për Zhvillim Rural të Mjedisve Rurale

GLA PLAÇKOVICA (2018) Strategjia për Zhvillim Rural të Mjedisve Rurale

MKT (2013) Kalimi i Grave dhe Burrave të Moshës së Re në Tregun e Punës në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Zyra Ndërkombëtare e Punës, Gjenevë.

NMSM (2014) Organizimi Rinor në Maqedoni. Këshilli Rinor Kombëtar i Maqedonisë.

CRJI (2018) Qendra për Zhvillimin e Rajonit Juglindor të Planifikimit, <https://www.rdc.mk/>

INFORMACIONE PLOTËSUESE

Stole Gjeorgiev, contact@celor.org.mk, <https://celor.org.mk>

CELOR – QENDRA PËR ZHVILLIM LOKAL Radovish

Aleksandar Jashkov, info@kruna.mk, <https://kruna.mk>

Shoqata KRUNA PLUS Radovish